

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"THERANDA WINE"**

Në bazë të ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismes së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" si dhe të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë **06/10/2020.**, Themeluesit:

Marjo Qose , shtetas shqiptar i biri i Arqiles lindur ne Lushnje i datelindjes 01.02.1994, banues ne Tirane ne Rrugen Teodor Keko me nr Personal J40201026R

Deklaronë se ka vendosur të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare

Neni 1-Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është **"THERANDA WINE" SH.P.K**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet "SH.P.K" dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Shoqëria e ka selinë ne qytetin e Tiranës ne Rruga "Sotir Gurra" Pallati Mirdita construksion, Zone Kadastrale Nr 3866, Nr Pasurie 306/369


Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.

Neni 4- Objekti i veprimtarisë

Objekti i shoqërisë është si më poshtë:

- Tregtimin me shumice dhe pakice , import – eksport te pijeve alkolike dhe jo alkolike
- Tregtimin me shumice dhe pakice , import – eksport te pijeve alkolike dhe jo alkolike
- Import – Eksport mobilie te ndryshme ,aksesore per mobilie ,elektroshtepiake.
- Prodhim dhe shitje mobiliesh,lende te pare te gateshme dhe gjysem te gateshme me shumice dhe pakice.
- Import dhe tregetim te makinerive,paisjeve te ndertimit ,teknologjive te perpunimit dhe tregetimit te lendes drusore ,aksesoreve ,Elektroshtepiakeve dhe te gjitha produkteve te mobilerise.

Marjo Qose 

- Riparim dhe mirembajtje te mobilieve dhe te artikujve te drurit.
- Ndertim dhe projektim te objekteve te ndryshme ,shtepi ,vila,ndertesa shumekateshe dhe pallate.Ndertim objektesh civile ,turistike dhe industriale.
- Veprimtari tregtare,import – eksport ,tregetim te artikujve te konsumit te gjere Industrial e ushqimore ,me shumice e pakice.
- Ritje dhe riprollim, tregtim produkte bimore dhe shtazore
- Ndertim resortesh, restorante,hoteleri ,bar,agrobiznese,
- Trasport mallrash dhe udhtareve.
-

E gjithë veprimtaria e shoqerise,pavarsisht nga objekti i saj do te mbeshtetet ne licencat e leshuara per kete qellim nga organi kopetent shteteror

Kryerja e çdo operacioni ekonomik e juridik, prodhues dhe tregtar e financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, për të cilin, ne baze te legjislacionit shqiptar, kërkohet leje e posaçme nga organet kompetente të administratës publike, do të realizohet vetëm pasi të jetë siguruar leja përkatëse.

Neni 5- Kapitali Themeltar

1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000(njeqindmije)lek

Pjesëmaria e themelueses ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e saj si me poshtme:

1. **Marjo Qose , shtetas shqiptar i biri i Arqiles lindur ne Lushnje idatelindjes 01.02.1994, banues ne Tirane ne Rrugen Teodor Keko me nr Personal J40201026R** Zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (njeqindmije)lek qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Aksionari duhet te mbajne rreziqe (borxhet, detyrimet ligjore dhe financiare, etj) ne baze te perqindjes perkatese

Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar


Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë eshte vetem nje pjese e cila perben 100 % te kapitalit te shoqerise.

1. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne lek nga ortaku i vetem Z. Marjo Qose i biri i Arqiles i datelindjes 01.02.1994 me nr Personal J40201026R

Kuota me vlere te pergjithsme 100.000 LEK , qe perbene 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjtet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

Marjo Qose 

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8 - Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
3. **Administratori i parë i shoqërisë është:**
2. Z. Marjo Qose i biri i Arqiles i datelindjes 01.02.1994 me nr Personal J40201026R caktohet si administrator i shoqërisë me afat 5 vjeçar i rinovueshem.
4. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyrë të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.
- 2.

Neni - 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

Parë dhe miratuar në Tirane , më 06.10.2020

Marjo Qose 